Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr./Br. 207/19
Data/Datum 10.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 207/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Pastor Kosova''shpk –Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me ekstrat për formimin e shkumës për NJPZSH" me nr. i prokurimit 651-19-1352-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjilanit, më datë: 31.05.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Pastor Kosova''shpk –Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ekstrat për formimin e shkumës për NJPZSH" me nr. i prokurimit 651-19-1352-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjilanit.

II. **ANULOHET,** njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me ekstrat për formimin e shkumës për NJPZSH" me nr. i prokurimit 651-19-1352-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjilanit, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Pastor Kosova''shpk –Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 20.03.2019.
Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 27.03.2019.
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 25.04.2019.
Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 26.04.2019,
Me dt: 30.04.2019, Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit, ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: "Pastor Kosova''shpk –Prishtinë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: "Pastor Kosova''shpk –Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.05.2019, me nr.207/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me ekstrat për formimin e shkumës për NJPZSH" me nr. i prokurimit 651-19-1352-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjilanit, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 56, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.05.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e dt: 22.05.2019, sqaron se Autoriteti Kontraktues, lidhur me kërkesën për rishqyrtim ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, dhe e ka refuzuar ankesën e OE ankues si të pa bazuar pasi qe konsideron se çmimi i ofruar konsiderohet i lartë.
I pa kënaqur me përgjigjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim OE "Pastor Kosova " shpk parashtron ankesë në OSHP-ë, për shkelje të dispozitave të LPP-së, të lartë cekura në ankesë.

Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar për faktin se AK sipas njoftimit për kontratë dhe në dosje te tenderit ka paraparë vlerë të përafërt me ofertën e OE "Pastor Kosova " i cili ishte i vetmi ofertues.

Operatori ekonomik ankues çmimi e lartë e arsyeton me kualitetin e produkti të ofruar dhe se konsideron se çmimi është i arsyeshëm karshi kualitetit. Autoriteti kontraktues gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk e ka anuluar aktivitetin në fjalë në përputhje me kërkesat e nenit 62 të LPP-së.

Duke u bazuar në sqarimin e lartë cekur, Eksperti Shqyrtues i rekomandon Autoritetit Kontraktues qe të rivlerësohet aktiviteti i prokurimit pasi pretendimet ankimore të ngritura nga OE ankues, lidhur me anulimin e procedurës së prokurimit i konsideron të bazuara.

Operatori ekonomik "Pastor Kosova''shpk –Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 23.05.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.05.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 31.05.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për anulim, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Imeri deklaroj: Përshëndetje për të gjithë ky ka qen një tender publik ku kanë pas mundësi te gjithë OE tjerë. Prandaj ofertën qe kemi dhen e kemi pas parasysh qe mund të ketë edhe oferta tjera arsyetimi i Autoriteti Kontraktues se është çmimi i larte nuk qëndron sepse varësisht nga kualiteti është edhe kostoja e produktit "Orkide" nga Gjermania është një brendë ndërkombëtar qe ka këtë produkt me kualitet te larte, zakonisht çmimi furnizues te ky prodhues sillet rreth gjashtë (6) €, por ne rastet e shpeshta nga përvoja e jone me këtë materie zjarrëfiksat

furnizohen ne sasi 5.000L, e me shume ne ketë rast Autoriteti Kontraktues kërkesën e ka pas për 300 l, qe normalisht ndryshon edhe çmimi i furnizimit është me larte por edhe shpenzimet tjera ndikojnë ne çmim si transporti dhe të tjera. Oferta jon prej 3.486 €, është brenda buxhetit te paraparë nga Autoriteti Kontraktues ne vlere prej 4.000 €. Asnjë nuk pajtohemi për një produkt për fikjen e zjarrit me qen jo kualitativ qe me shkuar zjarrefiksat për shuarjen e zjarrit te mos jep rezultat produkti të dështojnë ne shuarjen e zjarrit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së, znj. Hoxha deklaroj: Unë e kuptoj OE ne disa pika ka te drejt, Autoriteti Kontraktues duke e pare gabimin e vet qe ka lëshuar ne procesin e dosje pika e pare njësia kërkuese e ka hulumtuar çmimin e tregut dhe ka thirr ne tel OE ankues, dhe kanë dhen çmimin gjashtë (6) €, pasi qe kemi pas qe çmimi është i shtrejt kemi kërkuar edhe ne vende te tjera. Vlera e parashikuar ka qen për 600l, kur është përpunuar specifika paramasa ka mbet ky kriter. Komisioni vlerësues e kanë anuluar këtë AP.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z. Sheqiri deklaroj: Mbes pas raportit të dhen ne ekspertize.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së Imeri deklaroj: Të aprovohet ankesa jon si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Hoxha deklaroj: Kërkojmë qe të mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe te shkohet ne ritender.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se Autoriteti Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE ankues ka nxjerr vendim në përputhje me nenin 108/A, të LPP-së, dhe e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pa bazuar pasi qe konsideron se çmimi i ofruar nga OE në fjalë konsiderohet i lartë. I pa kënaqur me përgjigjen lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim OE "Pastor Kosova " shpk, parashtron ankesë në OSHP-ë, për shkelje të dispozitave të LPP-së, të lartpërmendura.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar për faktin se autoriteti kontraktues sipas njoftimit për kontratë dhe në dosje te tenderit ka paraparë vlerë të përafërt me ofertën e OE "Pastor Kosova", i cili ishte i vetmi ofertues. Ndërsa, operatori ekonomik ankues çmimi e lartë e arsyeton me kualitetin e produkti të ofruar dhe se konsideron se çmimi është i arsyeshëm karshi kualitetit të produktit.

Paneli shqyrtues duke u nisur nga te dhënat si me lart vjen në përfundim se anulimi i aktivitetit te prokurimit në fjalë është bere në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së. Prandaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë aktivitetet të prokurimit dhe kërkesave të dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Komuna e Gjilanit

1x1 OE -"Pastor Kosova''shpk –Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.